



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË
KORÇË

VENDIM
Nr 88 Datë 18.10.2010

PER

Miratim fondi për derdhjen e kontributit financiar të shoqërisë "Administrimi i mbetjeve të qarkut Korçë" (KRWM sh.a) për vitin 2010

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës "Për miratim fondi për derdhjen e kontributit financiar të shoqërisë « Administrimi i mbetjeve të qarkut Korçë » (KRWM sh.a) për vitin 2010 , bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, Ligji nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë» ligjin nr. 10190 dt. 26.11.2009 «Për buxhetin e vitit 2010», Udhëzimin nr.1 dt.21.01.2010 M.F «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2010», V.K.B nr. 20 dt. 25.03.2010 « Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2010», dhe mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratoje fondin për derdhjen e kontributit financiar të shoqërisë « Administrimi i mbetjeve të qarkut Korçë » (KRWM sh.a) për vitin 2010 me këtë strukturë buxhetore :

| | | | | | | |
|-----------|----|-------|----|-------------|---|--------------|
| PAKESOHET | 00 | 04980 | 05 | Art 6090000 | - | 346,710 leke |
| SHTOHET | 00 | 01110 | 05 | Art 6040000 | + | 346,710 leke |

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës si dhe Drejtoria Juridike

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

